

Komunat e Kosovës në ballafaqim me pandeminë globale

**CORONAVIRUS
COVID-19**


HULUMTIM

Organizatrat Jo-Qeveritare: Syri i Vizionit, Communication for Social Development (CSD), EC Ma Ndryshe dhe Demokrasi Plus (D+) kanë lidhur alenacë për zbatim të programit “Qytetaria aktive dhe komunat përgjegjëse në Kosovë” i cili mbështetet nga Olaf Palme International Center. Programi ka për qëllim përfshirjen dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.

Në kuadër të këtij programi, koalicioni ka iniciuar hulumtimin për grumbullimin e informatave rreth mënyrës se si komunat e Kosovës i janë përgjigjur dhe ballafaqohen me gjendjen e krijuar me pandeminë globale COVID-19. Po ashtu janë nxjerrë informata se çfarë shërbime i kanë ofruar qytetarëve të tyre. Në këtë hulumtim janë përfshirë të gjitha komunat e Kosovës.


Ky pyetësor i është dërguar të gjithë kryetarëve të komunave dhe kabinetit të tyre. Në përgjigjet kanë kontribuar edhe departamentet përkatëse të komunave. Krahas përgjigjeve komunat kanë dërguar edhe dokumente relevante që ndërlihen me këtë hulumtim.

Të dhënat e këtij hulumtimi pasqyrojnë gjendjen deri më datën 24 prill 2020.



Hulumtimi është kryer me pyetësor online, duke iu dërguar të gjitha 38 komunave të Kosovës si dhe duke i dhënë afat prej dhjetë (10) ditësh për plotësim. Të gjitha komunat janë kontaktuar përmes telefonit për t'u siguruar që kanë pranuar pyetësorin dhe përkujtuar atyre që të përgjigjen.


- Komunat që janë përgjigjur në hulumtim (32)
- Komunat që nuk janë përgjigjur në hulumtim (6)



Komunat e Kosovës në ballafaqim me pandeminë globale

CORONAVIRUS
COVID-19


1. Sa ka qenë komuna e juaj, në përgjithësi, e përgatitur për tu ballafaqur me virusin COVID-19?




2. Sa jeni të informuar për masat që i ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës për COVID-19?



3. Sa respektohen masat e vendosura nga Qeveria e Kosovës në komunën tuaj?



4. Në çfarë niveli është komunikimi i Komunës me nivelin qendror, konkretisht Ministrinë e Shëndetësisë?




Komunat e Kosovës në ballafaqim me pandeminë globale

**CORONAVIRUS
COVID-19**

Faqe 2


5. A keni pranuar paisje mbrojtëse (si dorëza, maska, dezinfektues, veshje mbrojtëse për staf mjekësor, etj) nga Ministria e Shëndetësisë?




25 komuna kanë ofruar listën detaje të paisjeve të ofruara nga Ministria e Shëndetësisë.

Komuna e Prishtinës është deklaruar se nuk ka pranuar paisje mbrojtëse nga Ministria pasi që janë dakorduar me Ministrinë që ato paisje të ipen komunave tjera që kanë buxhet më të vogël.

7. Sa jeni të kënaqur me komunikimin që keni me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)?



6. Sa jeni përkrahur nga ministritë tjera të Qeverisë së Kosovës në këtë kohë të pandemisë globale?



Në anketë, si përkrahje të Komunave pos Ministrisë së Shëndetësisë janë veçuar edhe **Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, si dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim.**

8. A e ka të formuar komuna e juaj shtabin emergjent lokal?


Të gjitha 32 komunat që kanë kthyer përgjigje kanë të formuara shtabet emergjente lokale.

27 komuna kanë ofruar emrat e anëtarëve të këtyre shtabeve, përfshirë pozitën, departamentet nga vijnë dhe kontaktet e tyre.

Në shumicën dërrmuese të komunave shtabet përbëhen nga kryetarët, nënkryetarët, kryesuesit e Kuvendit, përfaqësues të drejtorateve të ndryshme, anëtarë të kuvendeve komunale, zyrtarë për komunitete, polici, zjarrfikës, QKMF, Kryqi i Kuq, kompanitë publike të ujësjellësit, pastrimit, etj.

Në një numër të vogël të komunave, në shtab emergjent gjenden edhe përfaqësuesit e të rinjëve, komuniteteve fetare dhe të shoqërisë civile.

Numri mesatar i anëtarëve të shtabeve është **15**.



Komunat e Kosovës në ballafaqim me pandeminë globale

CORONAVIRUS
COVID-19

Faqe 3

9. Sa jeni të kënaqur me komunikimin që keni me Asociacionin e Komunave të Kosovës?

Të gjitha 32 komunat e anketuara kanë vlerësuar lartë që koordinimi dhe komunikimi i tyre me Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK) ka qenë i vazhdueshëm dhe shumë i dobishëm në harmonizimin e qëndrimeve dhe adresimin e kërkesave dhe nevojave të qytetarëve në ministritë përkatëse dhe Qeverinë e Kosovës. Si rezultat i kërkesave të AKK-së, komunat pretendojnë se kanë arritur që disa vendime të Qeverisë dhe ministrive të harmonizohen me kërkesat e tyre.

11. A ka shfrytëzuar komuna juaj Këshillat Lokale për komunikim me qytetarët?

24 komuna kanë deklaruar që Këshillat Lokale të të gjitha fshatrave janë kontaktuar dhe kanë pasur komunikim të vazhdueshëm me Shtabin Emergjent, në mënyrë për t'u njohur me shqetësimet e qytetarëve dhe veçanërisht për shpërndarjen edhe të ndihmave.

4 komuna kanë deklaruar që nuk kanë Këshilla Lokal funksional. Në ato raste janë shfrytëzuar Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi.

4 komuna nuk janë deklaruar fare.

10. A ka krijuar komuna një vegëz të veçantë në ueb faqen e komunës për informim të qytetarëve rreth simptomave, rreziqeve dhe parandalimit të shpërndarjes së virusit COVID-19?

23 komuna e kanë bërë në ueb faqen ekzistues si dhe në faqen zyrtare në Facebook.

4 komuna e kanë bërë në një ueb faqe të re si dhe në faqen zyrtare në Facebook.

4 komuna kanë hapur vetëm numër telefoni emergjent.


1 komunë ka ndarë njoftime vetëm në faqen Facebook.

12. A është aktivizuar sistemi online i aplikimit për dokumente të ofiçarisë?

Po, përfshi edhe e-kiosqet që shfrytëzohen për këtë qëllim (16 komuna).

Jo. Shërbimet merren në zyrët e ofiçarisë me staf të reduktuar. (8 komuna).

Pa përgjigje (8 komuna).



Komunat e Kosovës në ballafaqim me pandeminë globale

CORONAVIRUS
COVID-19

Faqe 4

**13. Përveç masave të vendosura nga Qeveria e Kosovës, a keni aplikuar edhe masa tjera shtesë si komunë?
Nëse po cilat?**

- 32 komuna - Formimi i Shtabit të Emergjencave
- 32 komuna - Dezinfektimi i objekteve komunale dhe atyre publike
- 32 komuna - Pajisje me mjete mbrojtëse për personel
- 32 komuna - Inspektime në terren për zbatim të masave
- 31 komuna - Dezinfekimi dhe pastrimi i rrugëve
- 31 komuna - Shpërndarje të pakove higjienike
- 30 komuna - Mbyllja e parqeve
- 30 komuna - Pezullim i lejeve për tubime publike
- 29 komuna - Caktimi i numrit telefonik kontaktues për qytetarët për kërkesa / shqetësime
- 27 komuna - Lehtësimi i mësimin online për nxënësit
- 26 komuna - Krijimi i grupeve vullnetare
- 25 komuna - Kufizimi i lëvizjes së automjeteve në zona të caktuara
- 24 komuna - Dezinfektim i hyrjeve të banesave kolektive
- 20 komuna - Ndarje të shujtave për rastet sociale
- 20 komuna - Vendosja e masave ekonomike
- 17 komuna - Përgatitje e QMF-ve me shtretër shtesë
- 16 komuna - Krijimi i karantinave
- 11 komuna - Dezinfektimi i transportit publik
- 2 komuna - Këshilla për biznese lokale
- 1 komunë - Shërbime për ndihmë psikologjike

**14. Shpjegoni se a po funksionon mësimi on-line për
nxënësit e komunës suaj?**


Shumica dërrmuese e komunave kanë deklaruar që mësimi on-line po funksionon mirë. Drejtoritë komunale të arsimit kanë përcjellur të gjitha informatat /udhëzimet/masat/vendimet nga MASHTI tek institucionet arsimore, stafi i tyre dhe nxënësit.

Në disa komuna, gjegjësisht në disa fshatëra, raportohet mungesa e rrymës dhe internetit.

Dy komuna nuk janë përgjigjur fare në këtë pyetje.

**15. A keni ndonjë dokument që shpjegon mënyrën se në
çfarë kapacitetesh janë duke punuar drejtoritë e
komunave?**

Po, shumica e komunave (26) kanë deklaruar se administrata e tyre punojnë me staf esencjal në departamente përkatëse, përderisa pjesa tjetër punojnë me kapacitet të reduktuar apo në distancë/online. Disa prej tyre kanë ofruar edhe dokumente shtesë si dëshmi. 6 komuna tjera nuk janë deklaruar fare.



Komunat e Kosovës në ballafaqim me pandeminë globale

**CORONAVIRUS
COVID-19**

16. Në çfarë mase janë duke funksionuar shërbimet publike në komunë?

	Furnizimi me ujë	26	Mirë, si zakonisht	3	E vështirësuar	2	Nuk funksionon	1	Nuk aplikohet / Pa përgjigje
	Pastrimi i rrugëve	31	Mirë, si zakonisht	1	E vështirësuar	0	Nuk funksionon	0	Nuk aplikohet / Pa përgjigje
	Menaxhimi i mbeturinave	31	Mirë, si zakonisht	1	E vështirësuar	0	Nuk funksionon	0	Nuk aplikohet / Pa përgjigje
	Trajtimi i ujërave të zeza	26	Mirë, si zakonisht	3	E vështirësuar	1	Nuk funksionon	2	Nuk aplikohet / Pa përgjigje
	Mirëmbajtja e parqeve	29	Mirë, si zakonisht	2	E vështirësuar	0	Nuk funksionon	1	Nuk aplikohet / Pa përgjigje
	Mirëmbajtja e hapës. publike	30	Mirë, si zakonisht	2	E vështirësuar	0	Nuk funksionon	0	Nuk aplikohet / Pa përgjigje
	Mirëmbajtja e rrugëve lokale	30	Mirë, si zakonisht	2	E vështirësuar	0	Nuk funksionon	0	Nuk aplikohet / Pa përgjigje
	Transporti publik	0	Mirë, si zakonisht	0	E vështirësuar	17	Nuk funksionon	15	Nuk aplikohet / Pa përgjigje


17. Sa është shuma e buxhetit (Euro) që ka ndarë komuna e juaj për luftimin e COVID-19?

1.380.000,00 Prishtinë
 400.000,00 Fushë Kosovë
 366.000,00 Podujevë
 250.000,00 Prizren
 229.200,00 Glogoc
 228.245,81 Gjilan
 200.000,00 Lipjan, Vushtrri
 170.000,00 Mitrovicë e Jugut
 150.000,00 Malishevë
 139.000,00 Skënderaj
 120.000,00 Dragash
 100.000,00 Shtime, Kaçanik, Obiliq, Deçan, Pejë, Viti



60.000,00 Suharekë
 50.000,00 Istog, Klinë
 20.000,00 Novobërdë
 15.000,00 Junik
 10.000,00 Hani i Elezit, Rahovec
 3.000,00 Partesh
 2.000,00 Mamushë
 1.000,00 Kllokot

Komunat e Gjakovës, Kamenicës, Ranillugut dhe Shtërpçës nuk kanë dhënë vlerë të buxhetit por kanë deklaruar se janë duke shpenzuar mjetet rezervë nga kategoria mallëra e shërbime.



Komunat e Kosovës në ballafaqim me pandeminë globale


CORONAVIRUS
COVID-19

18. A keni pasur përkrahje nga sektorët tjerë (donatorë apo sektor privat) përveç Qeverisë së Kosovës?

Po, shumica dërrmuese e komunave (30) kanë deklaruar se kanë pasur përkrahje jashtë institucioneve, kryesisht nga organizatat ndërkombëtare e lokale, biznese lokale, organizata humanitare dhe individë të ndryshëm filantrop. Ndihamat kanë qenë kryesisht në produkte e pako ushqimore si dhe materiale higjienike e mjekësore. Në vijim po japim listën e tyre:

- UNICEF
- Kryqi i kuq
- Arbeiter Samariter Bund Deutschland (ASB)
- Ambasada e Shqipërisë në Kosovë
- KFOR-i Turk
- TIKA
- Këshilli i Bashkësisë Islame
- Kampanja #700për700 nga diaspora
- Shoqatat bamirëse: Jetimat e Ballkanit, Bereqeti, Firdeus, Shqiptarët për shqiptarët dhe Opoja
- Fondacioni Labinot Tahiri
- Fondacioni Bonevet
- Qatar Charity
- ETC
- VIVA FRESH
- Buqaj
- Arjeta Group dhe QTA
- Benita Company
- Alba Group
- Madekos
- Market Meka
- Eurokos


19. A keni kërkuar ndihmën e ndonjë organizate vendore/lokale për ndonjë shërbim që ata janë të thirrur/profesionist?



Një numër i vogël i komunave (6) kanë deklaruar se kanë kërkuar ndihmë për pako ushqimore si dhe materiale higjienike e mjekësore nga disa organizata e kompani të cekuara në pyetjen paraprake.

Komuna e Prizrenit ka kërkuar ndihmë nga Universiteti i Prishtinës rreth projektit të këshillimit psikologjik për qytetarë.

Komuna e Vushtrrisë ka iniciuar procedurat për vlerësimin e dëmeve ekonomike nga COVID-19.



Komunat e Kosovës në ballafaqim me pandeminë globale

CORONAVIRUS
COVID-19

Faqe 7

20. A është bërë dezinfektimi i objekteve publike në komunën tuaj?

Të gjitha 32 komunat e anketuara kanë deklaruar që kanë dezinfektuar të gjitha objektet publike përfshi ndërtesat komunale, shëndetësore, edukativo-arsimore, fetare, etj. Disa nga komunat kanë dhënë informata më detaje rreth numrit të ndërtesave apo sipërfaqeve (në m²) të dezinfektuara.

Disa komuna kanë raportuar poashtu që kanë instaluar tunelet dezinfektuese në hapësira të spitaleve dhe ato publike.



21. Çfarë masa jeni duke marrë për personat/familjet me raste sociale?

Të gjitha 32 komunat e anketuara kanë deklaruar që personat / familjet me raste sociale janë ndihmuar me pako ushqimore dhe higjienike. Disa nga komuna kanë dhënë edhe statistiak e informata më detaje rreth këtyre ndihmave. Këto ndihma janë ofruar edhe përmes grupeve të ndryshme të vullnetarëve që kanë formuar komunat.



22. Çfarë masa jeni duke marrë për personat me aftësi të kufizuara?


Njëjtë sikurse rastet sociale, të gjitha 32 komunat e anketuara kanë deklaruar që edhe personat me aftësi të kufizuara janë ndihmuar me pako ushqimore dhe higjienike. Këto ndihma janë ofruar përmes koordinimit me OJQ që përfaqësojnë këto grupe të komunitetit.

KONKLUZIONE

Nga hulumtimi i aleancës “Qytetaria aktive dhe komunat përgjegjëse në Kosovë” të përbërë nga katër organizata të ndryshme mund të përfundojmë se komunat e Kosovës, marrë parasysh kapacitetet dhe buxhetin e tyre, janë ballafaquar relativisht mirë me situatën e pandemisë globale COVID-19. Komunat kanë pasur komunikim relativisht të mirë me nivelin qendror dhe me qytetarët e vet të cilët në masë të madhe kanë respektuar masat e Qeverisë së Kosovës. Kjo ka ndikuar që numri i të infektuarve dhe të vdekurve në krahasim me shtetet e rajonit apo edhe më gjërë të jetë relativisht më i vogël.

Sfidat kryesore me të cilat komunat e Kosovës ende ballafaqohen janë:

- Mungesa e mjeteve financiare nga niveli qendror për paisje shtesë mbrojtëse në luftimin dhe parandalimin e përhapjes së COVID-19.
- Mungesa e numrit më të madh të testeve rreth rasteve të dyshimta për COVID-19.
- Rritja e numrit të familjeve me gjendje ekonomike të rënduar dhe kërkesat e shtuara për pako ushqimore dhe higjienike.
- Mbyllja e shumë bizneseve private.
- Shqetësimet nga sektori i bujqësisë.
- Paqartësitë rreth lejeve të qarkullimit për qytetarë e biznese nga MPB.
- Paqartësitë rreth funksionimit të llojeve të ndryshme të bizneseve nga MEPTINIS.
- Numri i vogël i inspektorëve komunal.



Komunat e Kosovës në ballafaqim me pandeminë globale

CORONAVIRUS
COVID-19

Faqe 8

Rekomandime:

- Niveli qendror, lokal dhe shoqëria civile të punojnë në vetëdijësimin e vazhdueshëm të qytetarëve rreth respektimit të masave parandaluese dhe zbutjen e pasojave të pandemisë.
- Qeveria e Kosovës të hartojë një pako gjithpërfshirëse ekonomike për sektorin privat.
- Koordinim dhe konsultim më të strukturuar të Qeverisë së Kosovës me komunat në lidhje me masat mbrojtëse dhe parandaluese që do të mirren në të ardhmen.
- Komunat të aktivizojnë dhe funksionalizojnë Këshillat Lokal për komunikim më të mirë me qytatarë.
- Komunat të kërkojnë ndihmë profesionale nga organizata e kompani të ndryshme rreth përballimit të gjendjes së pandemisë.